



REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më: 16.03 - 20 23		
Njësia Jednica:	Numri Broj:	Shtojca Dodatak:
05-400/01-13624		



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Lipjan, 16.03.2023

Bazuar në rregulloren MF – Nr04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve:

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të Regjistruara në Republikën e Kosovës, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në **avancimin dhe afirmimin e kulturës në Komunën e Lipjani dhe përmbushjen e objektivave të thirrjes publike.**

1. Thirrja publike organizohet në kuadër të Aktiviteteve të Qerslorit, ku DKRS organizon aktivitete të ndryshme argëtuese dhe kulturore duke përfshi Festivalin e Qokolladës, Karnevalin e Fëmijëve dhe Koncertin e Ditës së Çlirimit

Objektivat e thirrjes:

1. Promovimi i kulturës,
2. Aktivitete të qëndrueshme,
3. Zgjerim i ngjarjeve kulturore,
4. Promovim i artit dhe kreativitetit,
5. Të përkrahen aktivitetet e reja kulturore/artistike.

Aktivitete:

- Festivali i Qokolladës dhe Karnevali i Fëmijëve (organizim 1 ditorë)
- Koncerti i Ditës së Çlirimit (organizim 1 ditorë)

Vërejtje: Aktivitetet do të organizohen në sheshin "Adem Jashari" në qytetin e Lipjanit dhe do të zgjasin 2 ditë në data të ndryshme (1 qershor dhe 12 qershor)

Përfituesi do të kujdeset për:

PËR FESTIVALIN E QOKOLLADËS DHE KARNEVALIN E FËMIJËVE

- Të siguroj 5 këngëtarë eminent për fëmijë dhe të ftohen fituesit e festivalit "Lipjani Këndon 2022" (përzgjedhja të bëhet në bashkëpunim me DKRS-në),
- Të siguroj minimum 5 shtëpiza druri, që të jenë në shërbim të operatorëve ekonomik që do të përzgjedhen nga OJQ përfituese në bashkëpunim me DKRS-në, (2 ditë qëndrim)
- Të siguroj zërimin dhe ndriqimin profesional,
- Të siguroj binë profesionale me dimension 6x4 dhe ekranin lled,
- Të kujdeset për organizimin e Festivalit dhe Karnevalit me moderim, sigurim, fotograf profesional me pamje nga droni dhe foto të eventit,
- Të siguroj pano me përmbajtje të aktiviteteve (minimum 10 pano me dimensione 1x1.5m)
- Të publikoj në projekt shpërblimet e për vendet e para të festivalit.
- Të siguroj minimumi 10 maskota që do të qëndrojnë në shesh gjithë ditën,
- Të siguroj pjesëmarrjen e fëmijëve në bashkëpunim me të gjitha shkollat e Komunës së Lipjanit,
- Te siguroj trenin lëvizës në shesh,
- Të bëjë dekorin e sheshit Adem Jashari në festën e fëmijëve në shtyllat e sheshit me balona të ndryshëm me helium,
- Të siguroj nga një thënje në formë baneri në secilën shtyllë të sheshit për të drejtat e fëmijëve,
- Të kujdeset në organizimin e mirë të ndarjes së fëmijëve gjatë gjirove me trenin lëvizës,
- Të siguroj program argëtues dhe muzikë për fëmijë, gjatë gjithë ditës në sheshin e Lipjanit,
- Të siguroj shfaqje teatrale për fëmijë pas përfundimit të muzikës dhe argëtimit të fëmijëve
- Te siguroj minimum 200 ulëse para skenës për shfaqjen e fëmijëve.

PËR KONCERTIN FESTIV TË DITËS SË ÇLIRIMIT

- Të siguroj binë profesionale me dimension 6x4 dhe ekranin lled,
- Të siguroj zërimin dhe ndriqimin profesional,
- Të kujdeset për organizimin e Koncertit Festiv me moderim, sigurim, fotograf profesional me pamje nga droni dhe foto të eventit,
- Të siguroj pano me përmbajtje të aktiviteteve (minimum 10 pano me dimensione 1x1.5m)
- Të siguroj 3 këngëtar eminent për performim në koncert (të përzgjedhen në bashkëpunim me DKRS-në)

SQARIM:

Organizata përfituese do të organizoj 2 ditë aktivitet për fëmijë dhe të rritur me datë 01.06.2023 dhe 12.06.2023. Preferohet të fillohet programi nga ora 11:00 deri në orën 19:00 (për ditën e fëmijëve), dhe koncerti festiv i datës 12 qershor të realizohet në orët e mbrëmjes, nga ora 18:00.

Dita e parë do të jetë 1 qershori Festivali i Qokolladës dhe Karnevali i Fëmijëve. Shtëpizat e drurit do të jenë në shërbim të operatorëve ekonomik vetëm për shitjen e qokolladave dhe pijeve jo alkoolike.

Bashkë me minimum 10 maskotat të sigurohen edhe personat që do të performojnë me to.

Treni lëvizës do të filloj aktivitetin me minimum 5 maskota në tren brenda, nga ora 13:30 deri në ora 15:30, ku organizata fituese do të kujdeset të bashkëpunoj me shkollat fillore të komunës së Lipjanit dhe të siguroj grupet që do të bëjnë gjiro më trenin lëvizës në sheshin e qytetit duke siguruar rend dhe rregull për funksionim të mirë të aktivitetit (sigurimi fizik, shiritat ndarës etj)

Të siguroj që shfaqja teatrale për fëmijë të ketë karakter argëtues dhe të siguroj shfaqje profesionale.

Organizimi i koncertit për ditën e çlirimit të bëhet në bashkëpunim me DKRS-në dhe përzgjedhja e këngëtarëve dhe reklamimi i aktiviteteve të bëhet së paku 10 ditë para nisjes së aktiviteteve (vlen edhe për 1 qershorin).

Kyqja dhe furnizimi me energji elektrike në përgjegjesin e përfituesit të projektit. Shpenzimet e energjis, pelqimet adekuate për kyqje dhe punët tjera shtesë të ndriqimit të terrenit i bart përfituesi i projektit.

Pastrimi i terrenit nga mbetirinat eventuale, mirëmbajtja e aseteve investive të Komunes dhe të përfituesit të projektit në vendin ku mbahen aktivitetet janë në përgjegjesin e përfituesit të projektit.

Dëmtimet eventuale të aseteve dhe pasurisë komunale në hapsirat ku shfrytëzohen për aktivitete brenda periudhës kur zhvillohen aktivitetet e bart përfituesi i projektit.

Pas përfundimit të aktiviteteve të projektit përfituesi duhet të kujdeset për kthim të hapsirave në gjendjen paraprake.

2.Organizatat jo-qeveritare mund të aplikojnë me një projekte që kontribuojnë në Avancimin dhe Fuqizimin e Kulturës në Komunën e Lipjanit.

3.Numri i OJQ-ve që do të mbështeten nga kjo thirrje është një (1) OJQ.

4.Vlera totale e planifikuar sipas thirrjes është 14,000.00 euro (katërmëdhjetë mijë euro)

5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me datën 05.04.2023.

6. OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti një (1) projekt në kuadër të kësaj thirrje dhe vetëm në fushat prioritare sipas thirrjes. Periudha e zbatimit të projektit është 1 muaj.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës para datës së publikimit të thirrjes publike. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e sportit dhe kulturës. OJQ duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Drejtoratit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare (<http://kk.rks-gov.net/lipjan/>).

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen personalisht, në adresën e mëposhtme:

KOMUNA E LIPJANIT

Rruga „Shqipëria”

Zyra për shërbim të qytetarëve , nr 3,

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

8. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: anila.reqica.llugiqi@rks-gov.net

Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport

Anila Reçica Llugiqi